Ekskluzive

# Ekskluzive | Këta janë tre të plagosurit nga të shtënat me armë në Podujevë, njëri kalimtar i rastit



Sinjali.com 02 Korrik 2026 15:06

**Sinjali mëson ekskluzivisht identitetin e tre personave që mbetën të plagosur në incidentin me armë zjarri që ndodhi në Podujevë.**

Sipas burimeve të Sinjalit, të plagosurit janë: **Fidaim Zejullahu**, rreth 36-vjeçar, me shtetesi gjermane, **Agim Xhemaji, Argjend Islami,** rreth 25 vjeç, i cili, sipas informacioneve fillestare, ishte kalimtar i rastit në momentin kur u hap zjarri.

Burimet tona bëjnë të ditur se deri në këtë fazë të hetimeve, njësitë policore kanë identifikuar dhe sekuestruar 23 prova materiale në vendin e ngjarjes, përfshirë armë, gëzhoja dhe dëshmi të tjera që pritet të ndihmojnë në zbardhjen e plotë të rastit.

Tre autoambulanca kanë transportuar të plagosurit nën përcjelljen e Policisë.

Policia dhe Prokuroria po vazhdojnë hetimet intensive për të sqaruar rrethanat e incidentit dhe për të identifikuar të gjithë personat e përfshirë.

Sinjali do t'ju mbajë të informuar për çdo zhvillim të ri lidhur me këtë rast.




Lexo edhe

Të shtënat në Podujevë, shkon në katër numri i të plagosurve – QKUK jep detaje për gjendjen e tyre



Lexo edhe

Policia jep detaje për të shtënat me armë në Podujevë, tre persona plagosen – dërgohen në QKUK


**Shënim: Personi i përmendur në këtë lajm konsiderohet i pafajshëm derisa fajësia e tij të vërtetohet me vendim të formës së prerë të gjykatës kompetente.**

***Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!***

**/GazetaSinjali/**


Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.




All rights are reserved 2025, Copyright Sinjali.com